



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:261729

Datë: 23.02.2024

Numri i dokumentit: 05365486

Ac.nr.261/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. H. nga fshati Sh.-Komuna e Mitrovicës, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Z. K. nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës-Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson G. B., për shkak të kompenzimit të dëmit material dhe jo material, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3129/2019 datë 14.09.2020 dhe aktgjykimit përmirësues C.nr. 3129/2019 të datës 05.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PJESËRISHT refuzohet si e pa themeltë ankesa e paditësit M. H. nga fshati Shipol, Komuna e Mitrovicës dhe në tërësi refuzohet e pa themeltë ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës-Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3129/2019 datë 14.09.2020, në pikën I dhe aktvendimi C.nr. 3129/2019 të datës 05.10.2020, VËRTETOHET.

PJESËRISHT aprovohet ankesa e paditësit M. H. nga fshati Shipol, Komuna e Mitrovicës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3129/2019 datë 14.09.2020, sa i përket shpenzimeve të procedurës, priset dhe çështja kthehet në ri vendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, C.nr.3129/2019 datë 14.09.2020, ka vendosur: APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësit M. H. nga fshati Sh., Komuna e Mitrovicës kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës-Prishtinë. I. OBLIGOHET e paditura që në emër të kompensimit të paditësit për lëndimin e pësuar në vendin e punës me date 05.05.2008 , për 30 % të përgjegjësisë sekondare , t'i paguaj shumat e specifikuara si më poshtë:

Dëmi jomaterial:

- kompensim në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, të mesëm dhe të lehtë, shumën prej750 Euro
- kompensim në emër të frikës shumën prej.....9.000 Euro
- kompensim në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ne shkalle prej 2%.....225 Euro.

REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë së paditësit kundër të paditurës, përtej shumave të gjykuara si në pikën një të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë ne emër të kompensimit për frikën në shumë prej 2.500 Euro, në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 3.000 Euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 6.000 Euro, në emër të kompensimit për shëmtimin trupor shumen prej 3.000 Euro, në emër të rehabilitimit klimaterik shumën prej 750 Euro, në emër të kompensimit për ndihmën e personit të tretë në shumë prej 300 Euro ,në emër të kompensimit për ushqim të përforcuar në shumë prej 300 euro, SI E PA BAZUAR.

DETYROHET e paditura, që paditësit për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë ti paguaj edhe kamatën vjetore ligjore prej 3.5% duke filluar nga data 17.06.2015 e deri në pagesën e plotë, në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbarimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që ta aprovoj në tërësi kërkesë padinë e paditësit si të bazuar si dhe të obligoj të paditurën në pagesën e shpenzimeve të procedurës.

Gjithashtu kundër këtij aktgjykimi, e paditura, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që ta refuzoj kërkesë padinë e paditësit si të pa bazuar, apo të njëjtin ta prishë dhe çështjen ta kthej në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, si dhe shikimin, analizimin dhe vlerësimin shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar

Ankesa e të paditurës është në tërësi si e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi M. H. nga fshati Sh., Komuna e Mitrovicës, me datën 18.09.2008, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, me kërkesë si në padinë e parashtruar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.344/2008 të datës 17.06.2015, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që ta refuzoj kërkesë padinë e paditësit si të pa bazuar, apo të njëjtin ta prishë dhe çështjen ta kthej në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendim AC.nr. 244/2016 të datës 06.09.2019 e ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 344/2008 të datës 17.05.2015, e ka prishur dhe çështja është kthyer në ri gjykim dhe ri vendosje.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.3129/2019 të datës 14.09.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar, ndërsa me aktvendimin C.nr. 3129/2019 të datës 05.10.2020, ka bërë përmirësimin e aktgjykimin të ankimuar, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e ankimuar ka arsyetuar se: Gjykata ka aprovuar propozimin e palës së paditur dhe ia ka dërguar lëndën për super ekspertizë Fakultetit Inxhinierisë Mekanike-Prishtine. Në super ekspertizën e përpiluar me shkrim Komisioni i ekspertëve ka dhënë mendimin e tij duke theksuar se përgjegjësinë primare për lëndimin në punë e ka paditësi sepse nuk ka bërë vendosjen e pjesës makinerike në vend të sigurt gjatë pastrimit të yndyrës dhe pakujdesia e tij gjatë pastrimit të pjesës makinerike edhe pse ka qenë i trajnuar dhe i pajisur me rrobat, këpucët dhe dorëzat e punës, kurse përgjegjësia sekondare e KEK-ut bazohet në angazhimin e punëtorëve me kualifikime tjera (saldues elektrik), në kryerjen e punëve të punëtorëve axhustatorë.

Më tej ka theksuar se: Për vërtetimin e kësaj gjendje gjykata e ka pranuar në tërësi si të besueshme super ekspertizën e lëmisë së mbrojtjes në punë duke e vlerësuar të njëjtën si profesionale dhe të argumentuar mirë. Lidhur me vërtetimin e shkallës së dëmit të pësuar dhe frikës së pësuar nga pala paditëse gjykata ka caktuar ekspertët nga lëmia ortopedisë-traumatologjisë dhe neuropsikiatrisë. Eksperti i lëmisë së ortopedisë-traumatologjisë në ekspertizën me shkrim të datës 14.12.2011 pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit ka konstatuar se lëndimet e pësuar nga paditësi karakterizohen si lëndime të rënda trupore, kurse ekspertja e lëmisë së neuropsikiatrisë në ekspertizën e datës 13.12.2011 ka caktuar intensitetin e frikës së pësuar nga paditësi. Gjithashtu për vërtetimin e frikës dhe natyrën e lëndimeve gjykata i ka pranuar në tërësi si të besueshme ekspertizat e ekspertëve nga lëmitë përkatëse.

Më tej ka theksuar se: nuk është kontestues fakti se paditësi në kohën e ndodhjes së aksidentit me datë 05.05.2008 ka qenë në marrëdhënie të punës me të paditurën. Gjithashtu nuk është kontestues fakti se deri te lëndimi i paditësit ka ardhur kur paditësi me datë 05.05.2008 rreth orës 11:00 gjatë orarit të rregullt të punës, duke pastruar labirintin i cili ka qenë përplot me yndyrë, e njëjta i ka rrëshqitur nga dora dhe i ka rënë në këmbën e majtë me c ‘rast e ka lënduar gishtin e madh. Gjithashtu nuk është kontestues fakti se përgjegjësinë primare për lëndimin në punë të paditësit e mbanë vet paditësi, kurse përgjegjësinë sekondare e mbanë e paditura, përkatësisht Korporata Energjetike e Kosovës.

Më tej ka theksuar se: për lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuara të dëmit jo material, gjykata vendosi në kuptim të nenit 200 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore. Me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësinë e shkëljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh që kompensimi të jetë satisfakcion për të dëmtuarin (i referohet dëmit jo material), duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit, si dhe duke pasur parasysh se me superekspertizën e lëmisë së mbrojtjes në punë përgjegjësinë primare për lëndimin në punë e mbanë paditësi.

Vendimi mbi kamatën e gjykuar është marrë në kuptim të nenit 186 dhe 277 të LMD-së së vitit 1978.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar në pjesën e vërtetuar nuk është i përfshirë në shkëlje të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e gjithashtu nuk përmban shkëlje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkëlje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i kjashtë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar e që aktgjykimin e ankimuar e bënë në harmoni të plotë me nenin 160 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit të paditësit për lëndimet e shkaktuara në vendin e tij të punës është në lartësinë e përcaktuar nga gjykata e shkallës së parë në shkallën e

30% të përgjegjësive së të paditurës, e që edhe gjykata e Apelit e përkrah një mënyrë të vendosjes, pasi që e njëjta është vërtetuar nga grupi i ekspertëve nga lamia e mbrojtjes në punë të cilët kanë konstatuar se përgjegjësinë primare për lëndimin në punë e ka paditësi sepse nuk ka bërë vendosjen e pjesës makinerike në vend të sigurt gjatë pastrimit të yndyrës dhe pakujdesia e tij gjatë pastrimit të pjesës makinerike edhe pse ka qenë i trajnuar dhe i pajisur me rrobat, këpucët dhe dorëzat e punës, kurse përgjegjësia sekondare e KEK-ut bazohet në angazhimin e punëtorëve me kualifikime tjera (saldues elektrik), në kryerjen e punëve të punëtorëve axhustatorë. Të cilës ekspertizë gjykata e Apelit ja fali besimin e plotë pasi që e njëjta është e punuar në mënyrë profesionale dhe shkencore e cila pasqyron edhe gjendjen faktike në tërësi.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur edhe në lidhje me lartësinë e kërkesës në lartësinë e 30% të përgjegjësive së të paditurës, pasi që e njëjta lartësinë e kërkesës e ka vërtetuar nga ekspertizat mjekësore që gjinden në shkresat e lëndës. Gjendjen faktike për dëmin jo material dhe material, për paditësin, gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes mendimit të ekspertit mjeko-ligjor, Dr. G. J., Ortoped si dhe Dr. N. H. – Psikiatër, për të gjitha elementet e dëmit jo-material duke u bazuar edhe në vlerësim të lirë nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Mendimet e ekspertëve mjeko-ligjor i ka vlerësuar si profesionale, gjithëpërfshirëse dhe reale, duke pas parasysh natyrën e lëndimit, kohëzgjatjen e dhimbjeve, frikën e përjetuar etj., dhe se kompensimi i dëmit jo-material dhe material në të holla ka për qëllim satisfaksionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi. Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet e duhura në arsyetim të aktgjykimit, për shumat e gjykuara sipas kategorive të dëmit si përfundim e ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësore, prandaj, Gjykata e Apelit vlerëson se shumat e aprovuara për dëmin jo materiale, janë në përputhje edhe me lëndimet e shkaktuara paditësit dhe të njëjtat paraqesin satisfaksion në raport me lëndimet e marra, intensitetin e dhimbjeve të frikës dhe zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, kohëzgjatjen e tyre si dhe kohën e nevojshme për shërimin, e të cilat janë konstatuar edhe nga ekspertizat e ekspertëve mjeko-ligjor, të cekur si më lartë. Në çdo rast për dëmin jo material, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin.

Gjykata e Apelit nuk i morri për bazë pretendimet e të paditurës në lidhje me aplikim të gabuar të së drejtës materiale pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur është bazuar në nenin Neni 136.1 të LMD-së, i cili parasheh që “*kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ia kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”, kurse me dispozitën nenit 183 par. 1 të LMD-së, për kompensimin e dëmit material dhe jo material si dhe lartësinë e dëmit, i cili parasheh që “*Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material*”. Ndërsa në paragrafin 2 të po të njëjtit nen është paraparë që “*Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen*

synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”. Andaj, gjykata e shkallës së parë, në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve, dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, rrethanat tjera, e sidomos moshën e paditësit si dhe praktika gjyqësore të cilat rezultojnë se shumata e gjykuara janë në përputhje me qëllimin shoqëror për kompensimin e dëmit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësit, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit.

Sa i përket vendimit për kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 186 dhe 277 të LMD-së së vitit 1978, i cili ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të dëmit, kamata kjo e cila fillon të rrjedhë nga data 17.06.2015, si datë e vendosjes sipas aktgjykimit C.nr. 344/2008 të datës 17.06.2008, pasi që në atë kohë është vendosur fillimisht për kompensimin e dëmit jo material.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi në lidhje me shpenzimet e procedurës kontestimore pasi që gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar, në dispozitiv fare nuk ka vendosur për kërkesën për shpenzimet e procedurës, por e njëjta vetën në arsyetim ka theksuar se gjykata në lidhje me shpenzimet e procedurës ka vendosur në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së, duke i specifikuar edhe shumën e tyre. Andaj, në mënyrë e vendosjes, për gjykatën e Apelit është e pa pranueshme dhe si të tillë në këtë pjesë çështjen e kthen në ri vendosje. Andaj, duke u nisur nga kjo gjendje, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të vendosë në kërkesën e paditësit në lidhje me shpenzimet e procedurës.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin dhe 195 par. 1 pika d) dhe c), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AC.nr. 261/2021, me datë 22.02.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari
Besnik Bislimaj, d.v